



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 106/3 Prot

Tiranë, më 30. 01 .2024

VENDIM

Nr. 03, datë 30. 01.2024

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 2352 prot., datë 20.12.2023, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik/Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, me anë të e-mail-it datë 04.12.2023, depozituar në adresën elektronike akbpm@shendetesia.gov.al, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni në lidhje me:

1. a) *certifikatën e origjinës së barit “L-Asparaginase” për vitin 2016-2022.*
b) *Autorizimin nga Ministria e Shëndetësisë.*
2. a) *certifikatën e origjinës së barit “Crisantaspase” (ERWINASE) për vitin 2022-2023.*
b) *Autorizimin nga Ministria e Shëndetësisë.*

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, në përfundim të afatit ligjor, ankuesi i është drejtuar Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri nëpërmjet shkresës nr. 2352/1 prot., datë 22.12.2023, drejtuar Autoritetit Publik dhe për dijeni ankuesit, ka kërkuar të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Në vijim të shkresës së sipërcituar, Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-it datë 28.12.2023, përcjellë më herët shkresën me nr. 4192 prot., datë 05.12.2023, ka kthyer përgjigje ankuesit duke e sqaruar se: “*...nuk është e mundur vënia në dispozicion e dokumentacionit të kërkuar i cili klasifikohet “sekret tregtar” përsa kohë përmban **informacione konfidenciale me natyrë teknike ose tregtare të një kompanie farmaceutike, informacione të cilat sigurojnë një avantazh konkurrues në treg dhe janë të panjohura për subjektet e tjera që operojnë në këtë fushë...***”.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin parashikohet se: “*...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve*”, bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me shkresën nr. 106/1 Prot., datë 15.01.2024, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore. Seanca u zhvillua me prezencën e ankuesit dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik. Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi z.

rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë. Ndërkohë, përfaqësuesit e Autoritetit Publik, znj. Sonila Shaho, në cilësinë e koordinatorit për të Drejtën e Informimit dhe znj. Migena Rizaj, në cilësinë e Shefit të Sektorit në “Sektorin e Çështjeve Juridike” i qëndruan pretendimit se edhe pse dokumentacioni/informacioni i kërkuar nga ankuesi disponohet nga Autoriteti Publik, ai nuk mund të vendoset në dispozicion të ankuesit pa marrë pëlqimin paraprak me shkrim nga Autoriteti i cili e ka përpiluar dokumentacionin, dhe se i qëndron plotësisht përgjigjes së dhënë në e-mailin e datës 28.12.2023 si dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, duke marrë përsipër edhe përgjegjësinë e trajtimit të kërkesës për informacion.

Pas konsultimit të legjislationit të posaçëm, qëndrimin të mbajtur nga Autoriteti Publik në seancën dëgjimore dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik për ankesën e paraqitur, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj*”. Në kuptim të këtij parashikimi, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.*

Konstatohet se, Autoriteti Publik nuk ka argumentuar lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar bazuar në kufizimet që parashikon neni 17 i LDI, si dhe nuk ka bërë një analizë të mirëfilltë apo të argumentojë se si kjo e drejtë kufizohet, kur është e domosdoshme, proporcionale, në mënyrë të tillë që të bënte dhe vlerësimin e interesit publik më të lartë. Në çdo rast, duke qenë se informacioni i kërkuar lidhet me fushën mjekësore dhe medikamente të rëndësishme, interesi publik për të aksesuar informacion/dokumentacion lidhur me prodhimin, importimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e tyre, në këtë rast është i drejtëpërdrejtë dhe tejet i lartë.

Referuar pretendimit të Autoritetit Publik se: *“...nuk mund të vendoset në dispozicion të ankuesit pa marrë pëlqimin paraprak me shkrim nga Autoriteti i cili e ka përpiluar dokumentacionin...”* dhe *“...nuk është e mundur vënia në dispozicion e dokumentacionit të kërkuar i cili klasifikohet “sekret tregtar”përsa kohë përmban **informacione konfidenciale me natyrë teknike ose tregtare të një kompanie farmaceutike, informacione të cilat sigurojnë një avantazh konkurrues në treg dhe janë të panjohura për subjektet e tjera që operojnë në këtë fushë...***”, Komisioneri vlerëson se pretendimet e ngritura nga ky i fundit, nuk u argumentuan në asnjë moment se në cilën pikë të nenit 17 të LDI, mbështeten si dhe nuk u paraqit asnjë provë për të mbështetur argumentin se janë dokumenta të cilat përmbajnë informacione konfidenciale të klasifikuara sekret tregtar, pasi informacioni i cili ndodhet në Autorizimin e Importit (*formë/doza, loti/seria, data e prodhimit, data e skadencës etj.*) është detyrim ligjor të jetë i publikuar në fletëpalosjen dhe amballazhin e vetë medikamentit në zbatim të nenit 49 dhe 50 të ligjit nr. 105/2014, “Për Barnat dhe Shërbimin Farmaceutik” dhe nenit 14 të vendimit nr. 299, datë 08.04.2015 “Për miratimin e Rregullores për Dhënien e Autorizimit të Tregtimit të Barnave e të Klasifikimit të tyre në Republikën e Shqipërisë”.

Referuar pretendimit të Autoritetit Publik, të ngritur gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, se në bazë të nenit 49 të Kodit të Procedurave Administrative vetëm Autoriteti Publik i

cili e ka përpiluar aktin mund ta shumëfishoj ose vërë në dispozicion të ankuesit, vlerësojmë se referenca në këtë parashikim është e gabuar dhe nuk qëndron. Neni 49 i Kodit të Procedurave Administrative parashikon se: *“Njësimi i akteve të veta: 1. Çdo organ publik, me kërkesë, mund të lëshojë kopje ose pjesë të njësuar me origjinalin të akteve të nxjerra nga ai vetë ose të dokumenteve të tjera nën administrimin e tij. 2. Njësimi me origjinalin nuk bëhet nëse, sipas rrethanave, rezulton se origjinali përmban ndryshime, mospërputhje, fshirje, fjalë, figura ose shenja të palexueshme, gjurmë të fshirjes së tyre, ose kur vazhdimësia e dokumentit të përbërë nga disa fletë është ndërprerë. 3. Përrjashtimisht, në rastet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, kur origjinali është ekzemplari i vetëm ekzistues i dokumentit, njësimi mund të bëhet duke bërë shënimin për mangësitë e konstatuara. 4. Njësimi me origjinalin bëhet nëpërmjet vendosjes së shënimit të njësimit në fund të kopjes. Ky shënim duhet të përmbajë: a) një përshkrim të saktë të dokumentit që njësohet; b) deklarin që kopja është e njëjtë me origjinalin ose që është një ekstrakt i tij; c) vendin dhe datën e njësimit; ç) organin publik që bën njësimin dhe vulën e tij zyrtare; d) emrin dhe nënshkrimin e nëpunësit përgjegjës për njësimin. 5. Afati për lëshimin e kopjes së njësuar është 10 ditë nga dita kur depozitohet kërkesa. 6. Në rast të mospërmbushjes së kërkesës apo refuzimit nga ana e organit publik, kërkuarit i lind e drejta për t’u ankuar për moslëshimin e kopjes së njësuar, sipas këtij Kodi. 7. Parashikimet e këtij neni zbatohen për aq sa është e mundur për njësimin me origjinalin të dokumenteve të tjera, të ruajtura në formën e fotografimit, filmimit apo të ruajtura në çdo mjet tjetër teknik.”.*

Nga sa më sipër, neni 49 i Kodit të Procedurave Administrative, përcakton rregullat e njësimit të akteve me origjinalin nga Autoriteti Publik dhe jo rregulla të aksesit në informacion/dokumentacion publik. Parashikimet e këtij neni në asnjë moment nuk bien ndesh me rregullimin e pikës 3 të nenit 3 të LDI, në të cilin parashikohet se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.”.* Ankuesi në kërkesën e paraqitur Autoritetit Publik ka kërkuar kopje të dokumentacionit të disponuar në baze të pikës 3 të nenit 3 të ligjit nr. 119/2014, “Për të Drejtën e informimit”, i ndryshuar.

Ndërkohë, referuar Vendimit nr. 142, datë 18.2.2015 “Për përcaktimin e rregullave për lëshimin e autorizimit të Ministrit të Shëndetësisë për importimin e barnave pa autorizim për tregtim”, në pikën 9 të tij parashikohet se: *“Të gjitha autorizimet e importit të lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë publikohen në faqen zyrtare të kësaj ministrie ose në buletinet përkatëse farmaceutike, brenda një afati tetë ditor nga momenti i lëshimit të tyre.”.*

Për sa më sipër, pretendimi i ngritur nga Autoriteti Publik, nuk qëndron pasi jo vetëm që nuk ndodhemi përpara kërkesës për kopje të dokumentacionit të njësuar me origjinalin dhe se nuk ekziston nevoja për marrjen e pëlqimit nga Autoriteti, por referuar parashikimit më sipër, vetë Autoriteti duhet ti bëjë publike në mënyre proaktive autorizimet e importit të lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, dokumentacioni i kërkuar, në parim përbën informacion publik bazuar në pikën 2, të nenit 2, të LDI sipas të cilës: *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse është prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të këtij ligji, i cili parashikon: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike. Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

Gjithashtu, kërkuar/ankuesi është gazetar, i cili synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik. Ky qëndrim i Komisionerit, gjën mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen *“Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë”*, vlerësoi se, pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e “mbikqyrësit shoqëror”, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 18, pikën 4 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së _____, nr. 2352 prot., datë 20.12.2023, ndaj Autoritetit Publik, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, me

- objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 04.12.2023, konkretisht: “1. (a) *çertifikatën e origjinës së barit “L-Asparaginase” për vitin 2016-2022. b) Autorizimin nga Ministria e Shëndetësisë. 2. a) çertifikatën e origjinës së barit “Crisantaspase” (ERWINASE) për vitin 2022-2023. b) Autorizimin nga Ministria e Shëndetësisë.*”, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, brenda datës 07. 02. 2024.
 3. Dënimin e znj. Sonila Shaho, në cilësinë e koordinatorit për të Drejtën e Informimit, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, në përputhje me pikën 4 të nenit 19 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore bazuar në pikën 1 dhe 2 të nenit 21 të ligjit të sipërcituar. Gjoha ekzekutohet nga Drejtoria e Financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit në përputhje me nenin 23 të ligjit të sipërcituar.
 4. Dënimin e znj. Migena Rizaj, në cilësinë e Shefit të Sektorit në “Sektorin e Çështjeve Juridike”, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, në përputhje me pikën 4 të nenit 19 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore bazuar në pikën 1 dhe 2 të nenit 21 të ligjit të sipërcituar. Gjoha ekzekutohet nga Drejtoria e Financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit në përputhje me nenin 23 të ligjit të sipërcituar.
 5. Kundër vendimmarrjes në pikat 1 dhe 2, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
 6. Kundër vendimmarrjes në pikat 3 dhe 4, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ, ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
 7. Ky vendim u shpall sot në datë 30. 01. 2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi